



## **THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE NË GRUPIN PUNUES PËR HARTIM TË STRATEGJISË ANTI-KORRUPSION**

Agjencia kundër Korrupsion është duke kërkuar tre përfaqësues të shoqërisë civile për të qenë pjesë e grupit punues për hartim të Strategjisë Anti-Korrupsion. Sekretariati i CiviKos do të lehtësoj procedurat e përzgjedhjes sipas Rregullores së Punës të CiviKos.

### **Kriteret për organizata që nominojnë përfaqësuesit e tyre në grup punues:**

- Organizata të ketë mision transparencën dhe luftimin e korrupsionit
- Të kenë publikime në lidhje me aktivitete të ndryshme Anti-Korrupsion, duke përfshirë vlerësime të rrezikut nga korrupsioni.
- Raporte të ndryshme të monitorimit rreth perceptimit të korrupsionit në Kosovë.

### **Kriteret për personat që nominohen për grup punues:**

- Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën e anti-korrupsionit
- Të kenë kompetenca në hartim të strategjive dhe masave anti-korrupsion
- Të njohin rrethanat e politikave anti-korrupsion në Kosovë
- Të jenë persona me integritet të lartë moral

### **Për të nominuar një kandidat/e, OSHCja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:**

1. Një cv të kandidatit/es së nominuar
2. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së ose një dokument që dëshmon aktivitetin e rrjetit jo-formal.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net), ose në zyrat e Platformës CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

**Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 10.02.2017 ora 16:00**

### **Në rast të procedurave të votimit**

**Në rast se kemi më shumë se 3 kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës të CiviKos. Kandidatet që marrin më së shumti vota do të jenë pjesë e grupit punues.**



Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i Agjencionit Anti-Korrupsion do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShc-ve për fushën përkatëse do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i femrave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.

Sekretariati i Platformës CiviKos